



Pranuar / Dorezuar Primihera/Prodato Received/Deliverty	23.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMBHC	5653/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr. 661/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 661/2022, të datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me përfaqësues juridik avokat me adresë banimi rruga kundër Vendimit me Nr.Ref.002/2022 të datës 29.06.2022 të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Francës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.09.2022 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr. 661/2022, e datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

**II. Mbetet ne fuqi** Vendimi me Nr.Ref.002/2022 i datës 29.06.2022 i Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Francës.

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas Vendimit me Nr.Ref.355/2020 të datës 14.07.2020 me Gradën Diplomatike Këshilltar, caktohet të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Paris Republika e Francës me mandat katër (4) vjeçar.

Ankuesi me datë 26.07.2022, me numër protokolli 4310/2022, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës me pretendimet ankimore kundër pikës 2 të vendimit me Nr.Ref.002/2022 të datës 29.06.2022 të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Francës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 01.08.2022, me numër protokolli 4455/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datë 12.08.2022 me numër protokolli 3677/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura.



Për shkak të specifikave të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 06.09.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.90/2022 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr. 661/2022 e datës 26.07.2022, me numër protokolli 4310/2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në kuadër të ARKS Paris me nr. Ref002/2022 i datës 29.06.2022; Ankesë e ankuesit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 03.06.2022; Plotësim Ndryshim i ankesës i datës 13.06.2022 me numër protokolli 3391/2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i KMPSHCK me numër A.nr.500/2022 i datës 07.07.2022 me numër protokolli 3977/2022; Vendim me Nr. Ref. 685/2018 i datës 24.07.2018; Vendim me Nr. Ref. 355/2020 i datës 14.07.2020; Vendim me Nr. Ref. 001 i datës 23.05.2022; Vendim me Nr. 223/2017 i datës 19.12.2017; Vërtetim me Nr. 105/2018 i datës 20.07.2018; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm i datës 11.11.2019; Vendim për sistemim të përkohshëm me numër ZSP-39/2018 i datës 30.03.2018; Autorizim i datës 19.07.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.08.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 3677/2022 e datës 12.08.2022; Vendim me Nr. 55/09 i datës 23.11.2009; Vendim me Nr. 190/2017 i datës 07.12.2017; Plani Individual vjetor i punës 2022 i F.Z. i datës 22.03.2022; Plani Individual vjetor i punës 2016 i F.Z.; Dëshmi e dokumenteve të dorëzuara i datës 22.06.2009; Rregullore Nr. 01/2019 për ndarjen e detyrave, përgjegjësi dhe raportimin e anëtarëve të personelit në misionet diplomatike dhe konsullore; Vendim për lëvizje paralele dhe transfer me Nr. 037/2015 i datës 20.10.2015; Vendim për lëvizje paralele dhe transfer me Nr. 600/2014; Vendim për lëvizje paralele dhe transfer me Nr. Ref. 389 i datës 18.07.2013; Shfuqizim të vendimit Nr.Ref. 325.2013 të datës 17.06.2013 me numër 388/2013 i datës 17.07.2013; Vendim me Nr. Ref. 256/2013 i datës 13.05.2013; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 23.08.2022; Vendim VK.nr.90/2022 i datës 06.09.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Ambasadori i Republikës së Kosovës në Republikën e Francës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.Ref.002/2022 të datës 29.06.2022 ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi.

Ligji Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Republikës së Kosovës konkretisht neni 8 paragrafi 8.1 përcakton se: *8.1 Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi konkretisht neni 2 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, tek përkufizimet, ka përcaktuar që: *“Shefi i misionit”- është ambasadori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga institucionet për ta ushtruar detyrën e tillë”,* rrjedhimisht edhe Ambasadori i Republikës së Kosovës në Republikën e Francës është shef i misionit diplomatik, ndërsa në bazë të neni 14 paragrafi 2 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Shefi i misionit ka autoritet mbi të gjitha shërbimet civile dhe ushtarake që ushtrojnë veprimtarinë në misionin diplomatik. Ai drejton, udhëzon, kontrollon dhe vlerëson të gjithë veprimtarinë zyrtare të personelit të misionit diplomatik, si dhe kryen funksione të tjera, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore”. Bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas dispozitave të lartcekura, Shefi i*

Misionit ndarjen e detyrave, përgjegjësive dhe raportimin e anëtarëve të personelit në misionet diplomatike dhe konsullore, ka kompetenca që të bëjë edhe sipas dispozitave të Rregullores Nr. 01/2019 për Ndarjen e Detyrave, Përgjegjësive dhe Raportimin e Anëtarëve të Personelit në Misionet Diplommatike dhe Konsullore.

Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me Nr.Ref.002/2022 të datës 29.06.2022 të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Francës, si dhe duke marrë për bazë kompetencat e Shefit të Misionit, të përcaktuar me dispozitat e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ndarja e detyrave dhe përgjegjësive të shërbimit konsullor për ankuesin nuk bien në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore në fuqi për shkakun që kjo ndarje është bërë në mënyrë të përkohshëm deri në emërimin e Konsullit apo Zëvendës Konsullit në këtë shërbim, sepse në rastin e tillë duke marrë për bazë që Ambasada e Republikës së Kosovës në Republikën e Francës është një ambasadë me rëndësi për Republikën e Kosovës, njëkohësisht edhe shërbimi konsullor është i rëndësishëm për qytetarët e Republikës së Kosovës që janë me vendqëndrim në Republikën e Francës, rrjedhimisht Ambasadori i Republikës së Kosovës në Republikën e Francës duke marrë parasysh këtë fakt ka bërë e ndarjen e detyrave për ankuesin sipas Vendimit me Nr.Ref.002/2022 të datës 29.06.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ambasadori i Republikës së Kosovës në Republikën e Francës si shef i misionit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.Ref.002/2022 të datës 29.06.2022, ka vepruar në pajtim të plotë me nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, nenin 4 dhe nenin 5 të Rregullores Nr. 01/2019 për Ndarjen e Detyrave, Përgjegjësive dhe Raportimin e Anëtarëve të Personelit në Misionet Diplommatike dhe Konsullore, kështu që Ambasadori i Republikës së Kosovës në Republikën e Francës lidhur deri te kjo vendimmarja ka marrë parasysh të gjitha kriteret e përcaktuar me nenin 5 të Rregullores Nr. 01/2019 për Ndarjen e Detyrave, Përgjegjësive dhe Raportimin e Anëtarëve të Personelit në Misionet Diplommatike dhe Konsullore.

Sa i përket pretendimeve të ankuesit që emërimi i konsujve bëhet nga Ministri i Punëve të Jashtme, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që në rastin konkret sipas Vendimit me Nr.Ref.002/2022 të datës 29.06.2022 të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Francës nuk është bërë emërimi i konsullit, por është bërë vetëm ndarja e detyrave përkohësisht me qëllim të menaxhimit më të mirë të punëve dhe realizimit të detyrave duke pas parasysh kapacitetet përfaqësuese aktuale që ka Ambasada e Kosovës në Francë, andaj Kolegji konstaton se kjo ndarje e këtyre detyrave dhe përgjegjësive është bërë në bazë të gjitha kompetencave ligjore të tij dhe se pretendimet e ankuesit lidhur me ndarjen e këtyre detyrave janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me Nr.Ref.002/2022 i datës 29.06.2022 i Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Francës, nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që vendimi i kontestuar me ankesë i përmban të gjitha elementet e aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 1.2 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një*

*përfashtim të tillë*”, ashtu i njëjtë është në pajtim me nenin 48 të këtij ligji, si rrjedhojë, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Nga të lartcekurat Kolegji konstaton se Vendimi me Nr.Ref.002/2022 i datës 29.06.2022 i Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Francës është nxjerr në pajtim me legjislacionin në fuqi, ndërsa me këtë rast ankuesit nuk i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e tij e punës dhe nuk është bërë diskriminim ndaj tij.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A. nr. 661/2022**

**Çlirim ZEKA**

  
Procesmbajtës

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- *Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit*
- *Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së,*

